



## MEMORANDUM

për

### LIGJIN SHQIPTAR PËR SHPIFJEN

nga

#### ARTIKULLI 19

### Fushata Globale për Shprehjen e Lirë

Londër  
Shtator 2004

**Me kërkesë të Përfaqësuesit të Organizatës për Sigurim dhe  
Bashkëpunim në Evropë për Lirinë e Medias**



## ***I. Hyrje***

Ky memorandum ofron një analizë për ligjin shqiptar civil dhe penal për shpifjen, duke përfshirë dispozita në lidhje me të drejtën e përgënjeshtimit, përkundrejt standardeve ndërkombëtare për lirinë e shprehjes. Komentet tona bazohen në një përkthim jozyrtar në gjuhën angleze të dispozitave përkatëse në Kodin Penal dhe Civil, si dhe të Ligjit për Radion dhe Televizionin, të ofruara nga Përfaqësuesi i Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë për Lirinë e Medias.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> ARTIKULLI 19 nuk mban përgjegjësi për saktësinë e përkthimit apo për komentet e mbështetura në një përkthim të gabuar apo çorientues.

ARTIKULLI 19 ka qenë prej kohësh i shqetësuar për përdorimin në Shqipëri të ligjit penal për shpifjen. Kodi Penal ndëshkon jo vetëm shprehjet shpifëse, por edhe “fyerjet”, një term që nuk është përkufizuar, madje ofron mbrojtje të veçantë për zyrtarët publikë. Dispozitat për shpifjen në Kodin Civil shqiptar janë po ashtu problematike, si përsa i përket formulimit të tyre të vagullt, ashtu edhe për faktin se nuk arrijnë të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme. Një studim i botuar në vitin 2002 zbuloi se, në praktikë, dispozitat penale për shpifjen përdoren shpesh. Është parë se gjykatat shumë shpesh marrin vendime kundër të pandehurve për shpifje, duke shfaqur një mungesë alarmante ndjeshmërie ndaj standardeve të përcaktuara sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Karikaturat satirike që komentojnë çështjet e përditshme klasifikohen si “fyerje”, gjykatat nuk arrijnë të bëjnë dallimin midis deklaramit të fakteve dhe opinionëve dhe ato mendojnë se gazetarët kanë vepruar me qëllim të keq në çdo rast. Një çështje e kohëve të fundit tregon në shumë mënyra problemet që ka ligji. Në maj të vitit 2004, botuesi i një gazete u gjobit me 2 milionë lekë (afërsisht 20 000 dollarë, rreth 100 herë më shumë se rroga mesatare mujore në Shqipëri) në një gjyq për shpifje të ngritur nga Kryeministri. Akuzat kishin të bënin me një shkrim opinion, sipas të cilit pretendohet se shpërblimi prej 5 rrogash mujore që mori Kryeministri, Shefi i Kabinetit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave për punën e bërë për privatizimin e Bankës së Kursimeve të Shqipërisë përbënin korrupsion. Çështja tani është në Gjykatën e Apelit.<sup>2</sup>

Kundrejt rasteve me përmbajtje të tillë, ligjet shqiptare për shpifjen veprojnë si një pengesë serioze për gazetarinë e pavarur dhe kritike. Ky memorandum analizon në hollësi dispozitat civile dhe penale për shpifjen, duke dhënë rekomandime për një reformë të përgjithshme. Rekomandimi ynë kryesor është që dispozitat penale për shpifjen të shfuqizohen dhe të zëvendësohen me dispozitat e duhura civile. Nëse shfuqizimi i dispozitave penale për shpifjen nuk mund të bëhet brenda një kohe të shkurtër, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë duhet të paktën të ndryshohet, në mënyrë që të shfuqizojë mbrojtjen e veçantë për figurat publike, për të siguruar mbrojtjen e duhur, për të shfuqizuar mundësinë e burgosjes, si dhe për të vënë një tavan për gjobat monetare dhe dëmshpërblimet. Kodi Civil duhet të ndryshohet, midis të tjerash, për të përcaktuar me kujdes dëmin e shkaktuar nga shpifja, për të përfshirë mbrojtjen e duhur dhe për të dhënë udhëzime për zhdëmtimet.

Detaje të analizës sonë përfshihen në Pjesën III të këtij Memorandumi. Pjesa II bën një përmbledhje të ligjit ndërkombëtar për lirinë e shprehjes dhe për shpifjen, mbi të cilat mbështetet kjo analizë, duke u përqendruar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Për më tej, kjo analizë mbështetet mbi një sërë standardesh për lirinë e shprehjes dhe shpifjen të shprehura në botimimin e ARTIKULLIT 19 të titulluar “Përkufizimi i Shpifjes: Parimet për Lirinë e Shprehjes dhe Mbrojtjen e Reputacionit (Përkufizimi i Shpifjes).<sup>3</sup> Këto parime, të cilat mbështeten në ligjin kushtetues krahasues, si dhe në jurisprudencën evropiane dhe të OKB-së për të drejtat e njeriut, kanë fituar mbështetje ndërkombëtare të konsiderueshme, duke përfshirë edhe atë të tre mandateve zyrtare për lirinë e shprehjes: Raportuesin Special të Kombeve të Bashkuara për Lirinë e

<sup>2</sup> ARTIKULLI 19 i shkroi Kryeministrit shqiptar për të protestuar lidhur me çështjen. Një kopje e letrës mund të gjendet në <http://www.article19.org/docimages/1775.doc>.

<sup>3</sup> Londër: ARTIKULLI 19, korrik 2000

Mendimit dhe Shprehjes, Përfaqësuesin e OSBE-së për Lirinë e Medias dhe Reportuesin e Veçantë të Organizatës së Shteteve Amerikane për Lirinë e Shprehjes.<sup>4</sup>

## **II. Detyrime Ndërkombëtare dhe Kushtetuese**

### **II.1. Garancia e Lirisë së Shprehjes**

Liria e shprehjes është një e drejtë kryesore e njeriut, në veçanti për arsye të rolit të saj themelor në mbështetje të demokracisë. Neni 19 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ)<sup>5</sup>, një rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, garanton të drejtën e lirisë së shprehjes si vijon:

Cdo njeri ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes, gjë që nënkupton të drejtën për të mos u prekur për shkak të opinionëve të tij si dhe të drejtën për të kërkuar, për të marrë dhe për të përhapur informata dhe ide me çfarëdo mjeti të mundshëm dhe pavarësisht nga kufijtë.

Formatted

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP)<sup>6</sup>, ratifikuar nga Shqipëria më 4 tetor 1991 shtjellon shumë nga të drejtat e përcaktuara në DUDNJ, duke vënë detyrime ligjore zyrtare mbi shtetet palë për të respektuar dispozitat e saj. Neni 19 i KNDCP-së garanton të drejtën e lirisë së shprehjes në terma shumë të ngjashëm me ato të nenit 19 të DUDNJ-së. Liria e shprehjes mbrohet gjithashtu në të tri sistemet rajonale të drejtave të njeriut, neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa Evropiane)<sup>7</sup>, e cila u ratifikua nga Shqipëria më 2 tetor 1996, neni 13 i Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut<sup>8</sup> dhe neni 9 i Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve.<sup>9</sup>

Neni 10(1) i Konventës Evropiane thotë, pjesërisht:

Cdo njeri ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur opinione dhe për të marrë e për të dhënë informacion e ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pavarësisht nga kufijtë.

Në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, të drejtat e garantuara në traktate ndërkombëtare, të cilat vendi i ka ratifikuar dhe pulikuar në Fletoren Zyrtare kanë përparësi ndaj çdo ligji apo praktike shqiptare, që nuk përputhen me to.<sup>10</sup> Kushtetuta e Shqipërisë, gjithashtu, garanton më vete të drejtën për lirinë e shprehjes, në nenin 10 (liria e shprehjes së besimit

<sup>4</sup> Shih Deklaratën e tyre të përbashkët të datës 30 nëntor 2000. Mund të gjendet në <http://www.unhcr.ch/hurricane/hurricane.nsf/view01/EF58839B169CC09C12569AB002D02C0?opendocument>.

<sup>5</sup> Rezoluta 217A(III) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, miratuar më 10 dhjetor 1948.

<sup>6</sup> Rezoluta 2200A(XXI) e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, miratuar më 16 dhjetor 1966, hyri në fuqi më 23 mars 1976.

<sup>7</sup> Miratuar më 4 nëntor 1950, hyri në fuqi më 3 shtator 1953.

<sup>8</sup> Miratuar më 22 nëntor 1969, hyri në fuqi më 18 korrik 1978.

<sup>9</sup> Miratuar më 26 qershor 1981, hyri në fuqi më 21 tetor 1986.

<sup>10</sup> Nenet 5 dhe 122 i Kushtetutës së Shqipërisë, miratuar më 21 tetor 1998, përkthyer nga K.Imholz, K.Loloci (Anëtar i Stafit Teknik të Komisionit Kushtetues dhe ACCAPP-së: <http://pbosnia.kentlaw.edu/resources/legal/albania/constitutional/>).

fetar në jetën publike), nenin 20 (liria e shprehjes së pakicave) dhe nenin 22 (liria e shprehjes dhe liria e shtypit, radios e televizionit).

Liria e shprehjes është një e drejtë themelore e njeriut, në veçanti për arsye të rolit të saj themelor në mbështetje të demokracisë. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme:

Liria e shprehjes përbën një ndër bazat themelore të shoqërisë (demokratike), një ndër kushtet bazë për progresin e saj dhe për zhvillimin e çdo njeriu.<sup>11</sup>

Gjykata gjithashtu e ka bërë të qartë që e drejta për lirinë e shprehjes mbrohet të folurën fyese. Është bërë një parim bazë në jurisprudencën e saj se e drejta e lirisë së shprehjes “zbatohet jo vetëm për ‘informacionin’ apo ‘idetë’ që priten mirë apo që konsiderohen jofyese apo si çështje indiference, por edhe për ato që fyejnë, trondisin ose shqetësojnë shtetin ose çdo pjesë të popullsisë. Të tilla janë kërkesat për pluralizëm, tolerancë dhe largpamësi, pa të cilat nuk ka ‘shoqëri demokratike’.”<sup>12</sup>

Në mënyrë të ngjashme, Gjykata thekson se “liria e gazetarit ... përfshin përdorimin e mundshëm të një shkalle ekzagjerimi, madje edhe provokimi.”<sup>13</sup> Kjo do të thotë, për shembull, që media është e lirë të përdorë hiperbolën, satirën apo figura të larmishme për të përçuar një mesazh të caktuar.<sup>14</sup> E ka media në dorë të përdorë formën e duhur të shprehjes. Për shembull, gjykata i ka mbrojtur gazetatat, që kanë zgjedhur t’i shprehin kritikën e tyre në formën e një karikature.<sup>15</sup> Edhe konteksti në të cilin bëhen deklaratat është i rëndësishëm. Për shembull, në çështjen e dytë të *Oberschlick*, Gjykata konsideroi se që të quajturit idiot e një politikani ishte një reagim i ligjshëm ndaj deklaratave të mëparshme provokuese të të njëjtit politikan, ndërsa në rastin e *Lingens*, Gjykata theksoi që rrethanat, në të cilat ishin bërë deklaratat e paditura “nuk duhet të anashkalohej.”<sup>16</sup>

Gjykata i jep vlerë të vecantë debatit politik dhe debatit për çështje të tjera me rëndësi publike. Çdo deklaratë e bërë gjatë zhvillimit të këtij debati mund të kufizohet vetëm atëherë kur është absolutisht e nevojshme: “Ka pak vend ... për kufizime të fjalimeve politike ose debateve për çështje me interes publik.”<sup>17</sup> Gjykata ka hedhur poshtë çdo dallim midis debatit politik dhe çështjeve të tjera me interes publik, duke deklaruar se nuk ka “justifikim” për një dallim të tillë.<sup>18</sup> Gjykata, gjithashtu, ka sqaruar që kjo mbrojtje e veçantë gjen zbatim edhe kur personi i sulmuar nuk është “figurë publike”;

<sup>11</sup> *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 dhjetor 1976, Aplikimi Nr.5493/72, paragrafi 49.

<sup>12</sup> *Po aty*. Deklarata të kësaj natyre janë të shumta në jurisprudencën e gjykatave e organeve të tjera gjyqësore në botë.

<sup>13</sup> *Dichand dhe të tjerë kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002, Aplikimi Nr. 29271/95, paragrafi 39.

<sup>14</sup> *Shih Karatas kundër Turqisë*, 8 korrik 1999, Aplikimi Nr. 23168/94, paragrafet 50-54.

<sup>15</sup> *Shih*, për shembull, *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, 20 maj 1999, Aplikimi Nr. 21980/93, paragrafi 63 dhe *Bergens Tidende dhe të tjerë kundër Norvegjisë*, 2 maj 2000, Aplikimi Nr. 26131/95, paragrafi 57.

<sup>16</sup> *Oberschlick kundër Austrisë* (Nr. 2), 1 korrik 1997, Aplikimi Nr. 20834/92, paragrafi 34; dhe *Lingens kundër Austrisë*, 8 korrik 1986, Aplikimi Nr. 9815/82, paragrafi 43.

<sup>17</sup> *Shih*, për shembull, *Dichan dhe të tjerë kundër Austrisë*, shënimi 13, paragrafi 38.

<sup>18</sup> *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, 25 qeshor 1992, Aplikimi Nr. 13778/88, paragrafi 64.

mjafton që deklarata të jetë bërë për një çështje me interes publik.<sup>19</sup> Rrjedhja e informacionit në çështje të tilla është caq e rëndësishme, saqë në një çështje të disa artikujsh gazetash që ngrinin akuza kundër gjuetarëve të fokave, çështje e një debati publik intensiv në atë kohë, sjellja e gazetarëve u konsiderua e arsyeshme dhe si rrjedhojë u mbrojt nga përgjegjësia ligjore, megjithëse ata nuk kërkuan komentet e vetë gjuetarëve të fokave lidhur me pretendimet e ngritura.<sup>20</sup>

Garantimi i lirisë së shprehjes zbatohet me një forcë të veçantë në media. Gjykata ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme “rolin e spikatur që luan shtypi në një shtet të së drejtës”<sup>21</sup> dhe ka deklaruar:

Liria e shtypit i siguron publikut një nga mjetet më të mira për të zbuluar dhe formuar një opinion për idetë dhe qëndrimet e udhëheqësve të tyre politikë. Në mënyrë të veçantë, ajo u jep politikanëve mundësinë për të pasqyruar dhe për të komentuar për shqetësimet e opinionit publik; kështu ajo i jep mundësinë secilit të marrë pjesë në një debat të lirë politik, gjë që qëndron në thelb të konceptit të një shoqërie demokratike.<sup>22</sup>

Pothuajse në çdo rast që i është paraqitur në lidhje me median, Gjykata ka theksuar “rolin thelbësor [të shtypit] në një shoqëri demokratike. Megjithëse nuk duhet t’i kalojë disa kufij, në veçanti përsa i përket respektimit të reputacionit dhe të drejtave të të tjerëve, detyra e medias, gjithsesi, është të japë - në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e saj - informacion dhe ide për të gjitha çështjet me interes publik. Jo vetëm media e ka për detyrë të përçojë informacion dhe ide të tilla, por edhe publiku ka të drejtë t’i marrë ato. Po të ishte ndryshe, shtypi nuk do të ishte në gjendje të luante rolin e tij jetësor të ‘rojes së publikut’.”<sup>23</sup> Në kontekstin e çështjeve për shpifje, Gjykata ka theksuar se detyra e shtypit shkon përtej raportimit të thjeshtë të fakteve; detyra e tij është t’i interpretojë faktet dhe ngjarjet në mënyrë që të informojë publikun dhe të kontribuojë në diskutimin e çështjeve me rëndësi për publikun.<sup>24</sup>

## II.2. Kufizime të së Drejtës së Lirisë së Shprehjes

Ligji ndërkombëtar lejon kufizime të pakta mbi të drejtën e lirisë së shprehjes, në mënyrë që të mbrojnë interesa të ndryshme, duke përfshirë edhe reputacionin. Parametrat e kufizimeve të tilla parashikohen në nenin 10(2) të Konventës Evropiane, e cila thotë:

Ushtrimi i këtyre lirive, duke qenë se mbart me vete detyra dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet formaliteve, kushteve, kufizimeve apo ndëshkimeve të tilla, siç përshkruhen në ligj, që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike, për parandalimin e prishjes të rendit apo krimeve, për mbrojtjen e shëndetit apo moralit, për mbrojtjen e reputacionit apo të të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e dhënies së informacionit të marrë në konfidencë apo për ruajtjen e autoritetit dhe paanësinë e gjyqësorit.

<sup>19</sup> Shih, për shembull, *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, shënimi 15.

<sup>20</sup> *Po aty*.

<sup>21</sup> *Thorgeirson kundër Islandës*, shënimi 18, paragrafi 63.

<sup>22</sup> *Castells kundër Spanjës*, 24 prill 1992, Aplikimi Nr. 11798/85, paragrafi 43.

<sup>23</sup> Shih, për shembull, *Dichand dhe të tjerë kundër Austrisë*, shënimi 13, paragrafi 40.

<sup>24</sup> *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 prill 1979, Aplikimi Nr. 6538/74, paragrafi 65.

Çdo kufizim i së drejtës së lirisë të shprehjes duhet të kalojë një test të rreptë të përbërë prej tri pjesësh. Ky test, i cili është konfirmuar si nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut<sup>25</sup>, ashtu dhe nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut,<sup>26</sup> kërkon që çdo kufizim duhet (1) të jetë i parashikuar në ligj, (2) të ketë për qëllim mbrojtjen e interesit të ligjshëm (duke përfshirë, siç u përmend, mbrojtjen e reputacionit të të tjerëve, në lidhje me komentet e përfshira këtu) dhe (3) të jetë i nevojshëm për të siguruar këtë interes. Në veçanti, që një kufizim të gjykohet i nevojshëm, ai duhet ta kufizojë lirinë e shprehjes sa më pak që të jetë e mundur, duhet të përpilohet me kujdes për të arritur objektivin në fjalë dhe nuk duhet të jetë arbitrar, i padrejtë apo i mbështetur në konsiderata të paarsyeshme.<sup>27</sup> Kufizimet e paqarta apo të përgjithshme, edhe nëse përmbushin kriterin “e parashikuar në ligj”, janë të papranueshme, sepse ato e tejkalojnë atë që kërkohet rreptësisht për mbrojtjen e interesave të ligjshme.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka vendosur që kjo përfaqëson një standard të lartë, të cilin duhet ta kalojë çdo ndërhyrje:

Liria e shprehjes, siç mishërohet në nenin 10, i nënshtrohet një sërë përjashtimesh, të cilat, megjithatë, duhet të interpretohen qartë dhe nevoja për çdo kufizim duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse.<sup>28</sup>

### **III. Analizë e Ligjit Shqiptar për Shpifjen**

Kjo pjesë analizon në mënyrë të hollësishme ligjin shqiptar civil dhe penal për shpifjen, si dhe ligjin për të drejtën e përgënjeshtimit, duke dhënë rekomandime për reformimin e tyre. Siç u tha edhe në hyrje, ne jemi shumë të shqetësuar për dispozitat penal, të cilat i kanë dhënë mundësi figurave publike të jenë të suksesshëm në ngritjen e padive për shpifje kundër gazetarëve lidhur me shkrime që kanë ngritur çështje me interes publik. Për këtë arsye, rekomandimi ynë më i rëndësishëm është që këto dispozita të shfuqizohen. Minimalisht, dispozitat e ligjit penal duhet të ndryshohen menjëherë në mënyrë që të përfshijnë mbrojtje kyçe, garanci procedurale dhe kufizime për gjobat dhe dëmshpërblimet që mund të caktohen. Gjithashtu është çështje përparësie që dispozitat ekzistuese civile, që nuk plotësojnë standardet e kërkuara nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, të zëvendësohen me rregullat e duhura të ligjit civil. Ne i shtjellojmë këto rekomandime të përgjithshme në paragrafët e mëposhtëm:

#### **III.1 Regjimi shqiptar penal për shpifjen**

Kodi Penal shqiptar përmban një sërë dispozitash që penalizojnë “fyerjen”, “shpifjen” dhe “poshtërimin” e subjekteve specifike. Dispozita të veçanta trajtojnë shpifjen dhe fyerjen dhe ka një mbrojtje të veçantë, ndër të tjera, për zyrtarët publikë, presidentin, personalitetet e huaja, si dhe flamurin. Nga pikëpamja e mbrojtjes së lirisë së shprehjes, të gjitha këto dispozita janë shumë problematike.

<sup>25</sup> Për shembull, në *Laptsevich kundër Bjellorusisë*, 20 mars 2000, Komunikata Nr. 780/1997.

<sup>26</sup> Për shembull, në *Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 mars 1996, Aplikimi Nr. 17488/90

<sup>27</sup> Shih *Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 26 prill 1979, Aplikimi Nr. 6538/74, paragrafi 49 (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut).

<sup>28</sup> Shih, për shembull, *Thorgeirson v. Islandë*, shënimi 18, paragrafi 63 (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut).

E drejta ndërkombëtare pranon se liria e shprehjes mund të kufizohet për të mbrojtur reputacionin individual, por ligjet për shpifjen, si gjitha kufizimet e tjera, duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me dëmin e shkaktuar dhe jo të shkojnë më tej se sa është e nevojshme në rrethana të veçanta. Dispozitat penale për shpifjen shkelin garantimin e lirisë së shprehjes, për shkak se mjetet më pak kufizuese, siç është ligji civil, janë të mjaftueshme për të zhdëmtuar dëmin dhe për shkak se sanksionet që ato parashikojnë nuk janë në përpjesëtim të drejtë me dëmin e shkaktuar.

Në të vërtetë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut asnjëherë nuk e ka përjashtuar shpifjen penale dhe ekziston një numër i vogël rastesh, ku ajo ka lejuar dënime penale për shpifjen, por ajo pranon qartë se ka probleme serioze me shpifjen penale. Ajo e ka përsëritur shpesh deklaratën e mëposhtme, që fillimisht u bë në një çështje për shpifje:

[P]ozicioni dominues që zë Qeveria e bën të nevojshme që ajo të tregohet e kufizuar në fillimin e procedurave penale, veçanërisht kur ka mjete të tjera për t'iu përgjigjur sulmeve të pajustificuara dhe kritikave të kundërshtarëve të saj apo medias.<sup>29</sup>

Pozicioni i marrë në sistemet e OKB-së dhe të OSBE-së ka qenë shumë më i prerë. Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, organi përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të KNDKP-së, në të cilën edhe Shqipëria është shtet palë, ka shprehur në mënyrë të vazhdueshme shqetësim rreth mundësisë së sanksioneve me burg për shpifjen.<sup>30</sup> Raportuesi Special i OKB-së për Lirinë e Mendimit dhe Shprehjes, emëruar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, u ka bërë thirrje shteteve të shfuqizojnë të gjitha ligjet penale për shpifjen, në favor të ligjeve civile për shpifjen.<sup>31</sup> Çdo vit, Komisioni për të Drejtat e Njeriut në rezolutën e tij mbi lirinë e shprehjes, vë në dukje shqetësimin e tij lidhur me “abuzimin me dispozitat ligjore për shpifjen penale”.<sup>32</sup> Së fundi, në Deklaratat e tyre të përbashkëta të muajit nëntor 1999, nëntor 2000 dhe përsëri në dhjetor 2002, tre mandatet e veçanta ndërkombëtare për promovimin e lirisë së shprehjes – Raportuesi Special i OKB-së, përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias dhe Raportuesi Special i Organizatës së Shteteve Amerikane për Lirinë e Shprehjes – u kërkuan shteteve të shfuqizojnë ligjet e tyre penale për shpifjen. Deklarata e Përbashkët e dhjetorit 2002 thotë:

Shpifja penale nuk është një kufizim i justifikueshëm për lirinë e shprehjes; të gjithë ligjet penale për shpifjen duhet të shfuqizohen dhe të zëvendësohen, aty ku është e nevojshme, me ligje të përshtatshme civile për shpifjen.<sup>33</sup>

<sup>29</sup> *Castells kundër Spanjës*, shënimi 22, paragrafi 46.

<sup>30</sup> Për shembull, në lidhje me Islandën dhe Jordaninë (1994), Tunuzinë dhe Marokun (1995), Mauritius (1996), Irak (1997), Zimbabve (1998), Kamerun, Meksikë, Marok, Norvegji dhe Rumani (1999), Kirgistan (2000), Azerbajxhan, Guatemalë dhe Kroaci (2001), si dhe Sllovaki (2003).

<sup>31</sup> Shih *Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të lirisë së mendimit dhe shprehjes*, Dokument i OKB-së E/CN.4/2000/63, 18 janar 2000, paragrafi 52 dhe *Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të lirisë së mendimit dhe shprehjes*, Dokument i OKB-së E/CN.4/2001/64, 26 janar 2001.

<sup>32</sup> Shih, për shembull, Rezolutën 2000/38, 20 prill 2000, paragrafi 3.

<sup>33</sup> Deklarata e Përbashkët e 10 dhjetorit 2002. Mund të gjendet në:

<http://www.cidh.oas.org/Relatoria/English/PressRel02/JointDeclaration.htm>.

Për sa më sipër, rekomandimi ynë kryesor është që të gjitha dispozitat e Kodit Penal për shpifjen të shfuqizohen. Megjithatë, nëse ligjet penale për shpifjen mbesin në fuqi, ato duhet të ndryshohen në mënyrë që të minimizojnë mundësinë për abuzime ose kufizime të pajustificuara të lirisë së shprehjes në praktikë. Në paragrafët në vijim, ne do të shtjellojmë ndryshimet minimale të nevojshme.

### III.1.1 Përkufizimi i Fyerjes dhe Shpifjes

Kodi Penal bën dallimin midis “fyerjes”, një term që është lënë i papërkufizuar, dhe “shpifjes”, së përkufizuar në nenin 120 si “[p]ërhapja e qëllimshme e thashethemeve, si dhe çdo informacioni tjetër që dihet se është i rreme, që cenon nderin dhe dinjitetin e personit”. Të dyja parashikojnë dënim me gjobë ose me burgim, gjobë më të lartë dhe burgim për një kohë më të gjatë, kur “fyerja ose shpifja bëhet publikisht, në dëm të disa njerëzve, ose në mënyrë të përsëritur”.

ARTIKULLI 19 beson se ligjet për shpifjen janë legjitime vetëm nëse qëllimi i tyre është të mbrojnë reputacionin e individëve – apo të subjekteve që gëzojnë të drejtën për të paditur dhe për t’u paditur - nga dëmtimet, duke përfshirë tendencën për të ulur respektin që gëzojnë në komunitet, duke i ekspozuar ndaj urrejtjes ose talljes së publikut, ose duke shkaktuar mënjanimin dhe shmangjen e tyre. Ligjet për shpifjen nuk duhet t’i mbrojnë njerëzit nga një gjuhë që është thjesht ofenduese ose tronditëse. Në këtë aspekt, është me vlerë të përmendet motoja e Gjykatës Evropiane që e drejta e lirisë së shprehjes “zbatohet jo vetëm për ‘informacione’ ose ‘ide’ që priten mirë ose që konsiderohen si jofyese apo si çështje indiference, por edhe për ato informacione dhe ide që fyejnë, trondisin apo bezdisin”.<sup>34</sup>

Në këtë kontekst, ne jemi të shqetësuar, së pari, për shkak të penalizimit “fyerjes”. Megjithëse është lënë e papërkufizuar, ne mendojmë se kjo i referohet deklaramit të opinioneve që nuk përmbajnë hamendësim të fakteve – përkundrajt “shpifjes”, e cila është përkufizuar specifikisht për t’iu referuar përhapjes së “informacionit të rremë”. Parimet e ARTIKULLIT 19, në pajtueshmëri me praktikat më të mira ndërkombëtare, përjashtojnë kufizimet për shpifjen në deklaramin e opinioneve:

Askush nuk duhet të jetë përgjegjës në bazë të ligjit për shpifjen për shprehjen e një opinioni.<sup>35</sup>

Edhe në ato raste ku përgjegjësia ligjore mund të parashikohet edhe për shprehjen e një mendimi, pranohet se kështu duhet të ndodhë vetëm për deklaratat më të rënda shpifëse, pa ndonjë bazë faktike dhe që synojnë veçanërisht të dëmtojnë reputacionin.<sup>36</sup> Pa kufizime të tilla, ata që kërkojnë të shmangin kritikën do të abuzonin pothuajse patjetër me çdo rregull që ndalon deklaramin e opinioneve. Ky shqetësim duket të jetë veçanërisht i vlefshëm në kontekstin shqiptar. Komentuesit raportojnë, se në disa raste, gjykatat e kanë interpretuar “fyerjen” si diçka që përfshin “fjalët, figurat apo veprimet poshtëruese,

<sup>34</sup> Shënimi 12, më sipër.

<sup>35</sup> Përkufizimi i Shpifjes, shënimi 3, Parimi 10(a).

<sup>36</sup> Shih, për shembull, *Unabhängige Initiative Informationsvielfalt kundër Austrisë*, 26 shkurt 2002, Aplikimi Nr. 28525/95, paragrafi 46 (Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut).



imorale dhe tallëse”, si dhe skicat satirike.<sup>37</sup> Një interpretim kaq i gjerë pothuajse e tejkalon atë çfarë mund të kufizohet sipas nenit 10 të Konventës Evropiane.<sup>38</sup>

Së dyti, ne jemi të shqetësuar për përfshirjen në përkufizimin e shpifjes të koncepteve shumë të ndryshme të ‘nderit’ dhe ‘dinjitetit’. Koncepti i dinjitetit njerëzor ka një natyrë jashtëzakonisht të përgjithshme, duke shërbyer si themeli filozofik i të gjitha të drejtave të njeriut dhe jo si bazë për dispozita ligjore të posaçme.<sup>39</sup> Si i tillë, ky koncept nuk mund të përkufizohet me saktësi dhe nuk e plotëson kriterin e theksuar në pjesën II.2, që kufizimet e lirisë së shprehjes të përcaktohen me terma të qarta. Koncepti i nderit do t’i referohej po aq vetëperceptimit sa dhe vlerësimit të një individi nga persona të tjerë. Duke pasur parasysh natyrën tepër subjektive të nderit si i tillë, si dhe bazat për kufizimin e lirisë së shprehjes në nenin 10 të Konventës Evropiane, e cila i referohet vetëm të drejtave dhe reputacionit, koncepti i nderit duket një bazë e papërshtatshme për mbrojtjen e reputacionit. Në vend të tij, ne rekomandojmë të përdoret termi i qartë dhe i saktë “reputacion”.

### III.1.2 Mbrojtja e Veçantë për Zyrtarët dhe Simbolet

Kodi Penal parashikon mbrojtje të veçantë për një shkallë të gjerë zyrtarësh publikë dhe simbolesh, duke mbrojtur zyrtarët, ku përfshihen gjyqtarët, presidenti, si dhe flamurin kombëtar dhe stemën. Në të vërtetë, të gjithë zyrtarët publikë gëzojnë mbrojtje të veçantë. Problemet e mëposhtme konsiderohen si vepra penale:

- “Fyerja e qëllimshme që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik, për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit” (Neni 239);
- “Shpifja e qëllimshme që i bëhet punonjësit që kryen një detyrë shtetërore apo një shërbim publik për shkak të veprimtarisë së tij shtetërore ose të shërbimit” (Neni 240);
- “Shpifja e qëllimshme ndaj Presidentit të Republikës” (Neni 241);
- “Poshtërimi, botërisht ose nëpërmjet botimeve apo shpërndarjes së shkrimeve, i Republikës së Shqipërisë dhe rendit kushtetues, i flamurit, i stemës, i himnit kombëtar, i dëshmorëve të kombit ose heqja, dëmtimi, prishja, bërja e padallueshme apo e papërdorshme e flamurit apo e stemës së Republikës të Shqipërisë të ekspozuara nga institucionet zyrtare” (Neni 268);
- “Fyerja e gjyqtarit apo anëtarëve të trupit gjykues, prokurorit, avokatit ose çdo arbitri të caktuar për një çështje për shkak të veprimtarisë së tyre” (Neni 318);

<sup>37</sup> I. Elezi, Ligji Penal, Pjesë e Veçantë, Vëll. 1, Tiranë: Shtëpia Botuese Luarasi: 1995, fq. 119-120, e cituar në *Çmimi i të folurit: Shkelja e Lirisë së Medias në Shqipëri*, Human Rights Watch: qeshor 2002, fq. 28.

<sup>38</sup> Shih, në këtë aspekt, vendimin e Gjykatës së Shkallës së Lartë të Parisit, më 25 prill 2001, që tregon se dispozitat franceze për “fyerjen” shkelin nenin 10 të Konventës Evropiane. Ky vendim iu referua vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për çështjen *Colombani*, shënimi 46, në të cilin u tha se dispozitat franceze nuk zbatohen më.

<sup>39</sup> Shih, për shembull, preambulën e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

- “Fyerja e bërë ndaj kryetarëve, anëtarëve të qeverisë, parlamentarëve të shteteve të tjera, përfaqësuesve diplomatikë apo të organizmave të njohur ndërkombëtare, që ndodhen zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë” (Neni 227); dhe
- fyerja e flamurit, emblemave ose himit kombëtar të shteteve të huaja dhe organizmave ndërkombëtare (Neni 229).

Dispozita të tilla bien në kundërshtim me nenin 10 të Konventës Evropiane. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka qenë shumë e qartë për çështjet e zyrtarëve publikë dhe të shpifjes: atyre u kërkohet t’i tolerojnë kritikën më shumë dhe jo më pak, pjesërisht për arsye të interesit publik në debatet e hapura rreth figurave dhe institucioneve publike. Në gjyqin e parë për shpifje, Gjykata theksoi:

Kufizimet e një kritike të pranueshme janë...më të gjera përsa i përket një politikani si i tillë sesa një personi fizik. Ndryshe nga ky i fundit, i pari në mënyrë të pashmangshme dhe me vetëdije është i hapur ndaj vëzhgimit të imtësishëm të çdo fjale dhe veprë, si nga gazetarët, ashtu edhe nga publiku i gjerë dhe, si rrjedhojë, duhet të shfaqë një shkallë më të madhe tolerance.<sup>40</sup>

Gjykata e ka pohuar këtë parim në disa raste dhe ky është bërë një parim themelor i praktikës së saj.<sup>41</sup> Ky parim nuk kufizohet me kritikën ndaj politikanëve në kapacitetin e tyre publik. Çështjet që lidhen me interesat private apo të biznesit mund të jenë një lloj me peshë. Për shembull, “fakti që një politikan është në një situatë, ku biznesi dhe aktivitetet e tij politike mbivendosen, mund të ngjallë debat politik, edhe atëherë kur nuk dalin probleme të papajtueshmërisë me detyrën e tij sipas ligjit vendas.”<sup>42</sup>

Në deklaratat për çështje me interes publik, parimi zbatohet për zyrtarët dhe nëpunësit civilë, si dhe për politikanët.<sup>43</sup> Në rastin e kohëve të fundit *Thoma kundër Luksemburgut*, Gjykata u shpreh:

Nëpunësit civilë, gjatë aktivitetit të tyre zyrtar, ashtu si dhe politikanët, i nënshtrohen një kufiri më të largët kritike të pranueshme sesa personat fizikë.<sup>44</sup>

Për më tepër, ne jemi të shqetësuar, pasi raportohet se gjykatat shqiptare aplikojnë një standard të çlirët në përkufizimin e ‘zyrtarëve publikë’, duke zbatuar pjesët 239 dhe 240 të Kodit Penal në rastet e mësuesve të shkollave publikë apo personelit mjekësor në sistemin e shëndetit publik.<sup>45</sup> Kjo rrit mundësinë për abuzim me këto dispozita.

<sup>40</sup> *Lingens kundër Austrisë*, shënimi 16, paragrafi 42.

<sup>41</sup> Shih, për shembull, *Lopes Gomez da Silava kundër Portugalisë*, 28 shtator 2000, Aplikimi Nr. 37698/97, paragrafi 30; *Wabl kundër Austrisë*, 21 mars 2000, Aplikimi Nr. 24773/94, paragrafi 42; dhe *Oberschlick kundër Austrisë*, 23 maj 1991, Aplikimi Nr. 11662/85, paragrafi 59.

<sup>42</sup> *Dichand dhe të tjerë kundër Austrisë*, shënimi 13, paragrafi 51.

<sup>43</sup> Shih *Janowski kundër Polonisë*, 21 janar 1999, Aplikimi Nr. 25716/94, paragrafi 33. Shih, gjithashtu, *Thorgeir Thorgeirson kundër Islandës*, shënimi 18.

<sup>44</sup> *Thoma kundër Luksemburgut*, ut 29 mars 2001, Aplikimi Nr. 38432/94, paragrafi 47.

<sup>45</sup> Ismet Elezi, Ligji Penal, shënimi 37, fq. 54-57.

Po ashtu, Gjykata Evropiane ka dhënë menjëherë vendimin për dispozitat që ofrojnë mbrojtje të veçantë për autoritetet e huaja. Në çështjen *Colombani dhe të tjerë kundër Francës*, thuhet:

Mos nënshtrimi i [Kryetarëve të Shteteve] ndaj kritikave vetëm për arsye të funksionit apo peshës së tyre, pa marrë parasysh interesin publik të kritikave ... çon në dhënien e një privilegji shumë të madh për kryetarët e shteteve të huaja, të cilët nuk mund të pajtohen me praktikat politike dhe modelet e sotme. Cilatdo qofshin interesat e dukshme çdo shteti për të ruajtur marrëdhënie miqësore me udhëheqësit e shteteve të tjera, ky privilegj e tejkalon atë që është e nevojshme për arritjen e një qëllimi të tillë.<sup>46</sup>

Edhe dispozita që ofron mbrojtje të veçantë gjyqësorit shkon shumë larg. Ndërkohë që Gjykata Evropiane ka njohur faktin se “puna e gjykatave, të cilat janë garantët e drejtësisë dhe që kanë një rol themelor në një shtet të së drejtës, duhet të gëzojë besimin publik [dhe] duhet, për këtë arsye, të mbrohet nga sulmet e pabaza”<sup>47</sup>, mbrojtja e gjithanshme e ofruar nga neni 318 nuk është në përpjesëtim të drejtë. Ashtu sikurse Gjykata e bëri të qartë në çështjen *Hrico kundër Sllovakisë*<sup>48</sup>, dispozitat që mbrojnë gjyqësorin duhet të lejojnë kritikën – duke përfshirë atë që mund të jetë formuluar në mënyrë agresive – në interes të publikut.

Përfundimisht, ARTIKULLI 19 beson se ligjet për shpifjen nuk duhet të përdoren për të mbrojtur reputacionin e objekteve si simbolet shtetërore apo fetare, flamujt apo stemat kombëtare; dhe as mund të përdoren për të mbrojtur reputacionin e shtetit apo të kombit si të tillë.<sup>49</sup> I vetmi justifikim për një ligj për shpifjen është qëllimi i tij i vërtetë dhe pasoja e dukshme e mbrojtjes së reputacionit të individit nga cenimi i respektit të tij, që, zakonisht, e ekspozon ndaj urrejtjes apo talljes publike, apo që i shkakton izolimin apo shmangien.

Duke pasur parasysh këtë, ARTIKULLI 19 rekomandon me forcë që në vend që t’u jepet mbrojtje e veçantë zyrtarëve publikë, standardi për shpifjen në çështjet e ngritura nga zyrtarët publikë duhet të jetë më strikt sesa standardi për individë të tjerë. Simbolet si flamuri apo himni kombëtar nuk meritojnë ndonjë mbrojtje specifike në ligjin për shpifjen.

### III.1.3 Sanksionet

Të gjitha dispozitat për shpifjen dhe fyerjen në Kodin Penal parashikojnë dënime me burgim, si dhe me gjobë. Këto janë dënime të ashpra.

Juridprudenca ndërkombëtare ka theksuar vazhdimisht rëndësinë mbizotëruese të garantimit të lirisë së shprehjes, që çon në një interpretim të ngushtë të qëllimit legjitim të kufizimit dhe sanksioneve. Kur vlerësohet legjitimiteti i kufizimeve, duhet marrë parasysh efekti “frenues” që sanksionet në shpërpjesëtim, apo edhe kërcenimi për sanksione të tilla, mund të kenë mbi rrjedhjen e lirë të informacionit dhe ideve.

<sup>46</sup> *Colombani dhe të tjerë kundër Francës*, 25 qeshor 2002, Aplikimi Nr. 51279/99, paragrafi 68.

<sup>47</sup> *Prager dhe Oberschlick kundër Austrisë*, 26 prill 1995, Aplikimi Nr. 15974/90, paragrafi 34

<sup>48</sup> 20 korrik 2004, Aplikimi Nr. 49418/99.

<sup>49</sup> Shih *Përkufizimi i Shpifjes*, Parimi 2

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka bërë të qartë se sanksione e ashpra të papërshtatshme, madje edhe për deklarata që janë konstatuar si shpifje, shkelin garantimin e lirisë së shprehjes. Ajo ka konstatuar se “çaktimi i dëmshpërblimit dhe dënimi përbëjnë qartë një ndërhyrje në ushtrimin e së drejtës të lirisë së shprehjes”<sup>50</sup>, dhe se çdo sanksion i vënë për fyerje duhet të përmbajë një “marrëdhënie të arsyeshme përpjestimore me dëmin që ka pësuar reputacioni.”<sup>51</sup> Gjoha shpërpjestimore të larta, si ato të vendosura në rastin e muajit maj 2004 trajtuar në Hyrjen e këtij dokumenti, shkelin të drejtën e lirisë së shprehjes.

Mundësia e burgimit për shpifje përbën shqetësim në veçanti; burgosja nuk duhet të jetë asnjëherë një sanksion për shkelje të ligjeve për shpifjen, pavarësisht sa e rëndë apo flagrante është deklarata fyese.<sup>52</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ka lënë asnjëherë në fuqi dënime me burg për shpifje. Megjithëse Gjykata ka lënë në fuqi dënime penale për shpifje, në këto raste, ajo është përpjekur shumë të nxjerrë në dukje se sanksionet kanë qenë modeste dhe, për rrjedhojë, plotësonin kushtin e përpjesëtimit. Për shembull, në çështjen *Tammer kundër Estonisë*, Gjykata theksoi në mënyrë të posaçme “shumën e kufizuar të gjobës së vënë”<sup>53</sup> në lënien në fuqi të dënimit; gjoba, në atë rast, ka qenë 10 herë më e lartë se paga minimale ditore.

Së fundi, sipas nenit 43 të Kodit Penal, gjykatat kanë pushtetin të urdhërojnë publikimin e vendimit gjyqësor nëse “njohja e përmbajtjes së vendimit përbën interes për persona juridikë e fizikë”. Gjykatat mund të urdhërojnë publikimin e vendimit gjyqësor jo vetëm në organin e shtypit që ka botuar shpifjen, por edhe në gazeta e televizione të tjera. Ne nuk besojmë se një kompetencë e tillë e përgjithshme është e përshtatshme. Ndërkohë që në disa vende gjykata ka kompetencë të urdhërojë që një gazetë të botojë një përmbledhje të konstatimeve kundër saj,<sup>54</sup> një urdhër që gazeta të botojë vendimin e plotë gjyqësor, në shumë raste, do të përbente një ndërhyrje shpërpjestimore në pavarësinë editoriale. Parashikimi, si në rastin e nenit 43, që edhe gazetave apo transmetuesve të tjerë t’u kërkohet të publikojnë vendimin gjyqësor, në asnjë rast nuk do të ishte një ndërhyrje e justifikueshme në pavarësinë editoriale. Nëse qëllimi është informimi i publikut, kjo arrihet më mirë nëpërmjet respektimit të lirisë së shprehjes. Nëse vendimi përbën për lajm, ka të ngjarë që një media e lirë ta pasqyrojë atë. Nëse jo, pak arrihet duke e detyruar median të pasqyrojë një histori që askush nuk do ta lexojë.

### III.1.4 Periudha e Kufizimit

Sipas nenit 66 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, paditë për shpifje mund të ngrihen deri në dy vjet pas publikimit të shpifjes, ose në rastin e shpifjes kundër Presidentit, deri në pesë vjet pas publikimit të shpifjes. Duke lejuar fillimin e çështjeve

<sup>50</sup> *Tolstoy Miloslavsky kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 13 korrik 1995, Aplikimi Nr. 18139/91, paragrafi 35.

<sup>51</sup> Po aty, paragrafi 49.

<sup>52</sup> *Shih Përkufizimin e Shpifjes*, shënimi 3, Parimi 4.

<sup>53</sup> 6 shkurt 2001, Aplikimi Nr. 41205/98, paragrafi 69.

<sup>54</sup> Ky është rasti, për shembull, në Francë: shih P. Carter-Ruck dhe H. Starte, *Carter-Ruck për Shpifjen e Shkuar dhe të Folur*, (Butterworths: Londër, 1997), fq. 363. Malta ka një dispozitë të ngjashme në Aktin e Shtypit (pjesa 20).

pas një periudhe kaq të gjatë nga shpërndarja e deklaratave mbi të cilat hapen këto çështje, rrezikohet aftësia e palëve të përfshira për t'u mbrojtur si duhet. Në të gjitha rastet, çështjet e zvarritura në mënyrë të panevojshme ushtrojnë një ndikim frenues mbi lirinë e shprehjes të të paditurit, si dhe mbi aftësinë e palës paditëse për të fituar dëmshpërblim të mjaftueshëm dhe në kohë. "Përkufizimi i Shpifjes" propozon një periudhë kufizimi prej një viti për ngritjen e padive për shpifje, përveç rrethanave të veçanta, një përjasje që është pranuar dhe/ose rekomanduar në disa juridiksione, megjithëse në kontekstin e ligjit civil.<sup>55</sup>

### **III.1.5 Mosmbajtja e përgjegjësisë ligjore**

Për mendimin tonë, shkalla e gjerë e përgjegjësisë ligjore për shpifjen si vepër penale në Shqipëri është seriozisht problematike për dy arsye. Së pari, mjafton që paditësit të paraqesin fare pak argumente në mënyrë që i padituri të dënohet. Së dyti, të akuzuarit nuk kanë mbrojtje të përshtatme në dispozicion.

ARTIKULLI 19 është i mendimit se ligjet penale për shpifjen gjithmonë e shkelin të drejtën e lirisë së shprehjes. Megjithatë, minimalisht, ato duhet të përmbushin disa standarde penale bazë. Këto standarde përcaktohen në "Përkufizimin e Shpifjes", si më poshtë:

- (b) Praktikisht, duke njohur faktin se në shumë shtete ligjet penale për shpifjen janë mjetet kryesore të trajtimit të sulmeve të pajustificuara ndaj reputacionit, duhet të merren hapa të menjëhershëm për të siguruar se çdo ligj penal për shpifjen që është ende në fuqi të jetë në përputhje të plotë me kushtet e mëposhtme:
- i. askush nuk duhet të dënohet për fyerje penale në qoftë se pala që pretendon se ndaj saj është shpifur nuk vërteton, përtej dyshimeve të arsyeshme, praninë e të gjitha elementeve të kundërvajtjes, siç përcaktohet më poshtë:
  - ii. nuk duhet të flitet për vepër të shpifjes penale, në qoftë se nuk vërtetohet se deklaratat cënuese janë të rreme, janë bërë me vetëdije që janë të rreme ose nga shkujdesja për të vërtetuar nëse janë apo jo të rreme, dhe se janë bërë me qëllimin e veçantë për të dëmtuar palën që pretendon se ndaj saj është shpifur...<sup>56</sup>

Ligji shqiptar e përfshin kriterin e shpifjes së qëllimshme, megjithëse nuk është e qartë se për çfarë qëllimi bëhet fjalë, qëllimin për shpifje apo thjesht qëllim për të shpërndarë deklaratat. Sidoqoftë, kjo nuk i plotëson standardet e përcaktuara më sipër, të cilat kërkojnë si qëllimin për shpifje, të qenit në dijeni, reale apo konstruktive, të faktit që deklaratat janë të rreme, ashtu edhe provën e pavërtetësisë. Për më tepër, prova, si në të gjitha çështjet penale, duhet të jetë e padiskutueshme.

Nëse shpifja penale vazhdon të konsiderohet si kundërvajtje, i akuzuari duhet të përfitojë një sërë mbrojtjesh. Në përputhje me pikëpamjen tonë kryesore se shpifja duhet të ketë natyrë civile, ne e paraqesim këtë në vija të përgjithshme më poshtë, në Pjesën III.2.2, e

<sup>55</sup> Shih, për shembull, Raportin e Grupit Këshillimor Ligjor për Shpifjen në Irlandë, botuar në mars 2003. Mund të gjendet në: <http://www.justice.ie/80256976002CB7A4/vWeb/fsWMAK4Q7JKY>. Shih, gjithashtu, *Përkufizimin e Shpifjes*, shënimi 3, Parimi 5.

<sup>56</sup> Shënimi 3, Parimi 4(b).

cila trajton mbrojtjen në kontekstin e ligjit civil. Mjafton të theksohet se asnjë prej këtyre mbrojtjeve nuk ekziston për shpifjen penale.

**Rekomandime:**

- Të gjitha dispozitat penale për fyerjen dhe shpifjen duhet të hiqen. Minimalisht, dhe si një masë afatshkurtër, dispozitat penale duhet të ndryshohen si më poshtë:
  - o Nuk duhet të ketë mbrojtje të veçantë për zyrtarët publikë, gjyqtarët, zyrtarët e huaj apo stemat shtetërore.
  - o Vepra e fyerjes duhet të hiqet dhe shpifja penale të kufizohet në rastet që përfshijnë fakte të rreme që dëmtojnë reputacionin.
  - o Sanksionet duhet të jenë rreptësisht përpjestimore ndaj çdo dëmi të shkaktuar. Në veçanti, burgimi nuk duhet përdorur asnjëherë si një sanksion për shpifjen.
  - o Gazetave dhe medias elektronike nuk duhet t'u kërkohej të publikojnë vendimet e gjykatës për shpifje kur ato nuk janë palë; nuk duhet të kërkohej që botimet që gjykohen fajtoresh për shpifje të botojnë vendimin e plotë kundër tyre, megjithëse, në disa raste, atyre mund t'u kërkohej të publikojnë një përmbledhje të shkurtër të këtij vendimi.
  - o Padia për shpifje nuk duhet të ngrihet më vonë se një vit pas botimit cenues.
  - o Palës që ngre një padi për shpifje penale duhet t'i kërkohej të vërtetojë gjithë elementët e veprës, siç përshkruhet më sipër, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.
  - o Duhet të parashikohet një mbrojtje e përshtatshme, siç jepet me hollësi në pjesën më poshtë, që flet për shpifjen civile.

### **III.2 Dispozitat civile për shpifjen**

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë nuk përmban shumë nene për shpifjen, përveç dy neneve të shkurtra, që lidhen drejtpërdrejt me të: neni 617 për 'publikimet mashtruese dhe të pasakta' dhe neni 625 për 'përgjegjësinë për dëmin jopasuror'. Përveç tyre, neni 618 parashikon përgjegjësinë ligjore të punëdhënësit për dëmet e shkaktuara nga punonjësit.

Neni 617 parashikon të drejtën e përgënjeshtimit të publikimit të të dhënave të pasakta, të paplota ose "mashtruese", që trajtohet më poshtë, në pjesën për të Drejtën e Replikës dhe Përgënjeshtimit. Neni 625 thotë:

Personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë të shpërblehet kur:

- a) ka pësuar një dëmtim të shëndetit ose është cënuar në nderin e personalitetit të tij;
- b) është fyer kujtimi i një të vdekuri dhe kërkohej nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë.

E drejta e parashikuar në paragrafin e mësipërm është e patrashëgueshme.

Këto dispozita nuk përbëjnë aspak një regjim të mjaftueshëm për shpifjen civile. Ato nuk e përkufizojnë shpifjen në mënyrë të mjaftueshme, nuk ofrojnë mbrojtjen e duhur, nuk parashikojnë përjashtime për forma të caktuara të shprehjes, si dhe nuk ofrojnë udhëzime lidhur me dëmet. Në paragrafët e mëposhtëm ne do t'i shtjellojmë këto shqetësime.

### III.2.1 Përkufizimi i Shpifjes

Neni 625 parashikon që një person mund të kërkojë dëmshpërblim, nëse dëmi është shkaktuar nga “cenimi i nderit të tij”. Ky nen nuk e përkufizon më tej veprën e shpifjes.

ARTIKULLI 19 nuk e konsideron këtë dispozitë si dispozitën e duhur për të mbrojtur reputacionin. Së pari, ajo hap rrugën për kërkesa për dëmshpërblim për deklaratat të vërteta që çenojnë nderin - për shembull, një pretendim i bërë kundër një ministri të qeverisë për abuzim me fonde shtetërore, që del i vërtetë. Ky nuk është përdorimi i duhur i ligjit për shpifjen. Parimi i dytë i *Përkufizimit të Shpifjes* thotë se “ligjet për shpifjen nuk mund të justifikohen, nëse qëllimi apo pasoja e tyre është mbrojtja e individëve kundër cenimit të reputacionit, të cilin ata nuk e kanë ose nuk e meritojnë... Në veçanti, ligjet për shpifjen nuk mund të justifikohen, nëse qëllimi apo pasoja e tyre është parandalimi i kritikave të ligjshme ndaj zyrtarëve apo ekspozimi i gabimeve ose korrupsionit të tyre.”<sup>57</sup>

Së dyti, siç u trajtua shkurt edhe në seksionin III.1 në lidhje me dispozitat penale për fyerjen, ligjet për shpifjen duhet të bëjnë dallimin midis deklaratave të fakteve dhe atyre të opinionëve. Në shkallë ndërkombëtare, pranohet se deklaratat e opinionëve meritojnë një shkallë të lartë mbrojtjeje. Për shembull, në çështjen e *Feldek kundër Sllovakisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk ishte dakort që përdorimi nga ana e aplikantit i shprehjes “e shkuar fashiste” të kuptohej si deklaram i faktit që një person ka marrë pjesë në veprimtari që propogandojnë ideale të veçanta fashiste. Gjykata shpjegoi se ky term ishte një term i gjerë që mund të përfshijë nocione të ndryshme, si përsa i përket përmbajtjes, ashtu edhe domethënies të tij. Një prej tyre mund të ishte se ky person kishte marrë pjesë si anëtar në një organizatë fashiste; mbi këtë bazë mund të arrihej në një gjykim subjektiv se personi kishte pasur një të ‘shkuar fashiste’.<sup>58</sup>

Së treti, neni 625/b i jep mundësinë individit të ngrëjë padi në emër të kujtimit të një të afërmi të vdekur. Ne nuk besojmë se kjo është e përshtatshme. Dëmi i shkaktuar nga një sulm i pajustificuar ndaj reputacionit të dikujt ka natyrë të drejtpërdrejtë dhe personale. Ndryshe nga prona, ky nuk është një interes që mund të trashëgohet; çdo interes që të afërmit që jetojnë ende mund të kenë për reputacionin e personit të vdekur është rrënjësisht i ndryshëm nga interesat që do të kishte një person që jeton për reputacionin e tij. Gjithashtu, mund të abuzohet lehtë me të drejtën për të ngritur padi për shpifje ndaj reputacionit të personave të vdekur, si dhe mund të pengohet debati i lirë dhe i hapur rreth ngjarjeve historike.

<sup>57</sup> Shënimi 3.

<sup>58</sup> 12 korrik 2001, Aplikimi Nr. 29032/95.

Së fundi, siç u vu në dukje në pjesën III.1, termi nder mund të interpretohet shumë gjerësisht, duke përfshirë vlerësimin që dikush ka për veten. Një term i preferueshëm në përputhje me instrumentet ndërkombëtare do të ishte termi 'reputacion'.

**Rekomandime:**

- Vepra e shpifjes duhet të përkufizohet qartë në mënyrë që të përfshijë vetëm deklaratat, që dëmtojnë reputacionin, përmes publikimit të një deklarimi të rremë faktesh.
- Nuk duhet të ekzistojë e drejta për të ngritur padi në emër të personave të vdekur.

### III.2.2 Mbrojtja në Çështjet e Shpifjes

Neni 625 nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme ndaj një akuze për shpifje. Në të vërtetë, nuk është e qartë se çfarë mbrojtje parashikon ky nen. Një sërë mbrojtjesh vlerësohen të nevojshme për të siguruar që ligjet për shpifjen të jenë në përputhje me garantimin e lirisë së shprehjes.

#### Botimi i Arsyeshëm

Të akuzuarit duhet të përfitojnë nga një mbrojtje e një justifikimi të arsyeshëm, që edhe deklaratat e rreme të mos konsiderohen përgjegjëse kur rrethanat e justifikojnë botimin. Rregulli i përgjegjësisë ligjore të rreptë për të gjitha deklaratat e rreme, është veçanërisht i padrejtë për median, e cila ka për detyrë të përmbushë të drejtën e publikut për t'u informuar për çështje me interes publik dhe shpesh media nuk mund të presë derisa të sigurohet që çdo pretendim është i vërtetë përpara se të publikojë ose transmetojë një kronikë. Edhe gazetaret më të mirë bëjnë pa dashje gabime dhe t'i lësh ata të pambrojtur ndaj çdo ndëshkimi për pretendime të rreme, do të thotë të dëmtojnë interesin e publikut për t'u informuar në kohë. Natyra e mediave informative është e tillë që ngjarjet duhet të publikohen kur ato përbëjnë lajm, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me çështje të interesit publik. Në një çështje ku ndërhyri ARTIKULLI 19, Gjykata Evropiane vendosi:

[L]ajmi është një produkt i përkohshëm dhe vonimi i publikimit të tij, qoftë edhe për një kohë të shkurtër, mund ta zhveshë atë nga çdo vlerë dhe interes.<sup>59</sup>

Një ekuilibrim më i përshtatshëm midis të drejtës së lirisë së shprehjes dhe reputacionit është mbrojtja e atyre që kanë vepruar në mënyrë të arsyeshme në botimin e një deklaratë lidhur me një çështje me interes publik. Media, duke vepruar në përputhje me standardet e pranuar profesionale, normalisht duhet ta kalojë testin e arsyes. Kjo është konfirmuar nga Gjykata, e cila ka deklaruar se shtypi duhet të lejohet të botojë artikuj që janë me interes publik, sipas dispozitës se "ai po vepron me qëllim të mirë për të ofruar një informacion të saktë dhe të besueshëm, në përputhje me etikën e gazetarisë".<sup>60</sup>

Duke i zbatuar këto parime në rastin e *Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut theksoi me forcë faktin se deklaratat e bëra në atë rast kishin të bënin me një çështje me interes të madh publik, të cilën gazeta paditëse e kishte

<sup>59</sup> *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2), 24 tetor 1991, Aplikimi Nr. 13166/87, paragrafi 51.

<sup>60</sup> *Bladet Tromsø dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, shënimi 15, paragrafi 65.



pasqyruar në tërësinë e vet në mënyrë të ekuilibruar.<sup>61</sup> Kjo është në vazhdim të linjës së ndjekur nga gjykatat kushtetuese të vendeve të ndryshme, të cilat e kanë pranuar parimin se atje ku shtypi ka vepruar në përputhje me udhëzimet profesionale, ai duhet të përfitojë nga mbrojtja që i jep botimi i arsyeshëm.<sup>62</sup>

Parimet e ARTIKULLIT 19 e përmbledhin këtë mbrojtje si më poshtë:

Edhe kur një deklaratë fakti për një çështje me interes për publikun vërtetohet të jetë e rreme, të paditurit duhet të përfitojnë nga mbrojtja e botimit të arsyeshëm. Kjo mbrojtje vendoset nëse gjykohet se ka qenë e arsyeshme në të gjitha rrethanat që një person në pozitën e të paditurit ta shpërndante materialin në mënyrën dhe formën që ai/ajo e ka shpërndarë. Për të përcaktuar nëse shpërndarja ka qenë e arsyeshme në rrethanat e një rasti të veçantë, Gjykata duhet të marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes përsa u përket çështjeve me interes publik dhe të drejtën e publikut për t'u informuar në kohë në lidhje me çështje të tilla.<sup>63</sup>

### Barra e Provës

Parimet e ARTIKULLIT 19 trajtojnë çështjen e barrës së provës, shpesh një çështje vendimtare në çështjet e shpifjes, duke parashikuar: “Në rastet që përfshijnë deklaratat për çështje me rëndësi për publikun, është paditësi ai që duhet të vërtetojë që deklaratat apo insinuatat që pretendohet se përbëjnë shpifje janë të rreme”.<sup>64</sup> Kjo rithekson parimin e përgjithshëm të zhvilluar nga gjykatat kushtetuese, duke përfshirë Gjykatën e Lartë Amerikane, se vendosja e barrës së provës mbi të akuzuarin do të kishte efekt frenues mbi të drejtën e lirisë së shprehjes. Në dhënien e vendimit të gjykatës në çështjen *New York Times kundër Sullivan*, Brennan J komentoi:

Lejimi i mbrojtjes së të vërtetës, ku barrën për ta provuar atë e ka i akuzuari, nuk do të thotë se do të pengohen vetëm deklaratat e rreme. Edhe gjykatat, që e kanë pranuar këtë mbrojtje si një garanci të mjaftueshme, kanë pranuar vështirësitë e sjelljes së provave ligjore për të provuar se shpifja e supozuar ka qenë e vërtetë në çdo pikë të saj... Me një rregull të tillë, ata që mund të kritikojnë sjelljen e zyrtarëve mund të frenoheshin e të mos i shprehnin kritikën e tyre, edhe po të besonin se janë të vërteta, apo edhe sikur të ishin në fakt të vërteta, për shkak se do të dyshonin nëse kjo mund të vërtetohet para gjykatës apo për shkak të frikës se do të duhej ta bënë këtë. Ata tentojnë të bëjnë vetëm deklaratat që ‘janë mjaft larg zonave të paligjshme’<sup>65</sup>

Gjykata Evropiane ka rënë dakort se në mënyrë të veçantë kur një gazetar raporton nga burime të besueshme, në përputhje me standardet profesionale, është e padrejtë që t'i kërkohet të provojë vërtetësinë e deklaratave.<sup>66</sup> Kështu ndodh, sidomos, kur publikimi ka të bëjë me çështje me rëndësi për publikun. Megjithatë, Gjykata ka kërkuar që kur bëjnë

<sup>61</sup> *Po aty*.

<sup>62</sup> Shih për shembull, *Reynolds kundër Times Newspapers Ltd dhe të tjerëve*, [1999] 4 All ER 609, fq. 625 (Dhoma e Lordëve); *National Media Ltd dhe të tjerë kundër Bogoshi*, [1999] LRC 616, fq. 631 (Gjykata e Lartë e Apelit e Afrikës së Jugut).

<sup>63</sup> *Përkufizimi i Shpifjes*, shënimi 3, Parimi 9

<sup>64</sup> *Përkufizimi i Shpifjes*, shënimi 3, Parimi 7(b).

<sup>65</sup> *New York Times Co. kundër Sullivan*, 376 US 254 (1964), faqe 279.

<sup>66</sup> Shih, për shembull, *Colombani kundër Francës*, shënimi 46, paragrafi 65.

akuza të rënda, gazetarët duhet të përpiqen shumë për të vërtetuar të vërtetën e tyre, sipas standardeve të përgjithshme profesionale.<sup>67</sup>

### Deklaratat e Mbrojtura

Në nivel ndërkombëtar, pranohet se lloje të caktuara deklaratash nuk duhet të shpallen përgjegjëse për shpifje. Përgjithësisht, këtu qëndron edhe interesi i publikut që njërëzit të jenë në gjendje të flasin lirshëm pa pasur frikë ose pa u shqetësuar se ata mund të mbajnë përgjegjësi ligjore për atë që kanë thënë. Kjo do të zbatohet, për shembull, në deklaratat e bëra në gjykatë, në legjislativ dhe para organeve të ndryshme zyrtare, siç e ka bërë të qartë Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.<sup>68</sup> Po kështu, duhet të mbrohen edhe raportimet e drejta dhe të sakta për deklaratat e tilla në gazeta e gjetkë.<sup>69</sup>

Parimi 11 i *Përkufizimit të Shpifjes* jep në mënyrë të hollësishme llojet e deklaratave, që duhet të gëzojnë mbrojtje të tillë, si më poshtë:

- (a) Lloje të caktuara deklaratash nuk duhet të mbajnë kurrë përgjegjësi ligjore në bazë të ligjit për shpifjen. Minimalisht, ato duhet të përfshijnë:
  - i. çdo deklaratë të bërë gjatë punimeve të organeve legjislative, duke përfshirë deklaratat e bëra nga anëtarët e zgjedhur, si në debate të hapura e komisione, ashtu edhe nga dëshmitarë të thirrur për të dhënë prova në komisionet ligjvënëse;
  - ii. çdo deklaratë të bërë, gjatë punimeve të autoriteteve vendore, nga anëtarët e këtyre autoriteteve;
  - iii. çdo deklaratë të bërë gjatë të gjitha fazave të proceseve gjyqësore (duke përfshirë proceset e bisedimit dhe paragjyqësore) nga kushdo që është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këto procese (përfshirë gjyqtarët, palët, dëshmitarët, këshillin dhe anëtarët e jurisë) për sa kohë deklaratat, në njëfarë mënyre, ka lidhje me procesin;
  - iv. çdo deklaratë të bërë para një organi me mandat zyrtar për të hetuar abuzimet me të drejtat e njeriut, duke përfshirë një komision për zbulimin e së vërtetës;
  - v. çdo dokument, që publikohet me urdhër të një organi ligjvënës;
  - vi. një raport të drejtë dhe të saktë të materialeve të përshkruara në pikat (i) – (v) më sipër; dhe
  - vii. një raport të drejtë dhe të saktë, ku statusi zyrtar i materialit justifikon shpërndarjen e këtij raporti, si për shembull dokumentacioni zyrtar lëshuar nga një hetim publik, një gjykatë e huaj, ligjvënës apo një organizatë ndërkombëtare.
- (b) disa lloje deklaratash duhet të përjashtohen nga përgjegjësia ligjore në qoftë se nuk provohet se janë bërë me dashakeqësi, në kuptimin e inatit apo mërisë. Këtu duhet të përfshihen deklaratat e bëra në mbrojtjen e një interesi apo kryerjen e një detyre ligjore, morale ose sociale.<sup>70</sup>

<sup>67</sup> *McVicar kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 7 maj 2002, 46311/99, paragrafet 84-86 dhe *Bladet Tromsø and Stensaas kundër Norvegjisë*, shënimi 15, paragrafi 66.

<sup>68</sup> Shih, për shembull, A. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 17 dhjetor 2002, Aplikimi Nr. 35373/97 (anëtarët e legjislativit duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë për deklaratat e bëra në kapacitetin e tyre zyrtar) dhe *Nikula kundër Finlandës*, 21 mars 2002, Aplikimi Nr. 31611/96 (deklaratat e bëra gjatë procesit gjyqësor duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë). Ne konstatojmë se një mbrojtje e tillë ofrohet nga neni 47 i Ligjit për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë.

<sup>69</sup> Shih, për shembull, çështjen *Bladet Tromsø and Stensaas kundër Norvegjisë*, shënimi 15 (media dhe të tjerët duhet të jenë të lirë të raportojnë saktë dhe duke u nisur nga një qëllim i mirë gjetje apo deklarata zyrtare).

<sup>70</sup> Shënimi 3.

<sup>71</sup> *Po aty*.

### Përgjegjësia Ligjore

Së fundi, duhet të ketë përgjashtime për lloje të caktuara mbajtësish informacioni. Sipas regjimit aktual, nuk është e pakonceptueshme që një *Internet Service Provider (ISP)* të mbajë përgjegjësi ligjore duke ofruar padashur akses në informacione fyese apo shpifëse të publikuara në Internet. Kjo nuk do të ishte e përshtatshme, pasi ISP-të nuk mund të konsiderohen ‘autorë’ të një informacioni të tillë. Përveç kësaj, ekziston një rrezik i rëndësishëm i ‘censurimit nga ana e ofruesit të internetit’: duke pasur parasysh përgjegjësinë ligjore që mund të mbajnë, shumë ISP thjesht do t’i heqin deklaratat nga Interneti sapo ato të akuzohen si shpifëse, pavarësisht nga ligjshmëria e akuzës.

Si pasojë, është pranuar se nevojitet një mbrojtje e veçantë në ligjin për shpifjen në lidhje me Internetin. Kjo pasqyrohet në Parimin 12(b) të *Përkufizimit të Shpifjes*, i cili thotë në pjesën përkatëse:

Organet, funksioni i vetëm i të cilave në lidhje me një deklaratë të veçantë kufizohet me ofrimin e aksesit teknik në Internet, kalimit të të dhënave nëpërmjet Internetit apo ruajtjes së plotë ose të pjesshme të një faqeje interneti nuk janë objekt përgjegjësie ligjore në lidhje me deklaratën, përveçse kur, në ato rrethana, pretendohet se ato e kanë ndryshuar deklaratën përkatëse.<sup>71</sup>

#### **Rekomandime:**

- Të akuzuarit për shpifje duhet përfitojnë nga mbrojtja që u jep botimi i arsyeshëm, siç përshkruhet më sipër.
- Në rastet që përfshijnë deklaratat për çështje me rëndësi publike, paditësi duhet të mbajë barrën e të vërtetuarit që deklaratat janë të rreme dhe jo t’i kërkohet të paditurit të provojë vërtetësinë e tyre.
- Disa deklaratat, si ato që përshkruhen më sipër, duhet të mbrohen nga përgjegjësia ligjore për shkak të interesit të prgjithshëm publik në bërjen ose shpërndarjen e tyre.
- Organet, funksioni i të cilave është të ofrojnë akses teknik në internet, nuk duhet të mbajnë përgjegjësi ligjore për informacionin në të cilin ato ofrojnë akses, përveçse atëherë kur pretendohet se ato kanë pranuar këtë deklaratë si të tyren.

### **III.2.3 Përgjashtime dhe Kufizime**

Siç u vërejt më lart, *Përkufizimi i Shpifjes* propozon një kohë limit prej një viti për ngritjen e padive për shpifje, përveçse në rrethana të jashtëzakonshme (shih pjesën III.1.4). Një kufizim i tillë nuk parashikohet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë. Neni 113 shprehet se një padi për të rivendosur ose mbrojtur të drejtën vetjake jopasurore, që përfshin reputacionin, mund të ngrihet në çdo kohë. Neni 115 përkufizon disa përgjashtime nga ky rregull i përgjithshëm, pa përfshirë shpifjen. Ne rekomandojmë që të merret në konsideratë parashikimi i një periudhe limit prej një viti për depozitimin e një padie për shpifje, përveç rrethanave të jashtëzakonshme. Kjo dispozitë mund të vendoset ose në nenin 115, duke specifikuar zbatimin e tij në një padi për shpifje, ose vetë në nenin 625.

**Rekomandim:**

- Paditë për shpifje nuk duhet të mund të ngrihen më shumë se një vit pas botimit të deklaratave akuzuese.

### III.2.4 Dëmtimet

Neni 625 shpreh se një person që pëson një dëm jopasuror ka të drejtën të kërkojë “dëmshpërblim”, por nuk përcakton kufij në lidhje me masën e dëmshpërblimit.

E drejta e lirisë së shprehjes kërkon që qëllimi i një dëmshpërblimi për deklarata shpifëse është, për të gjitha rastet, me përjashtim të atyre të jashtëzakonshme, i kufizuar në kompensimin e dëmit të menjëhershëm të reputacionit të personit/personave ndaj të cilëve është shpifur dhe se roli i dëmshpërblimit nuk është të ndëshkojë deklaruesin.<sup>72</sup> Siç e ka shprehur edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duhet të ekzistojë një përpjesëtim midis dëmit të shkaktuar dhe kompensimit të dhënë.<sup>73</sup>

Është parim i përgjithshëm i ligjit se pala paditëse në rastet civile ka për detyrë të lehtësojë dëmshpërblimin. Në fushën e ligjit për shpifjen, kjo nënkupton se pala paditëse duhet të përftojë nga çdo mekanizëm që mund të kompensojë ose lehtësojë dëmin e shkaktuar ndaj reputacionit të saj, siç janë mekanizmat e disponueshme përmes së drejtës për replikë dhe mekanizmat e përgënjeshtimit, të diskutuara më poshtë. Kjo do të thotë se gjykatat duhet t'i japin përparësi përdorimit të dëmshpërblimeve të mundshme jofinanciare në dëmshpërblimin e cenimit të reputacionit shkaktuar nga deklaratat shpifëse.

Kompensimi financiar për shpifje nuk duhet të jetë asnjëherë shpërpjesëtimor dhe duhet të jepet vetëm atëherë kur dëmshpërblimet jofinanciare janë të pamjaftueshme. Për të siguruar që çdo sanksion për shpifje është në përpjesëtim të drejtë me dëmin që ka pësuar ky reputacion, ligjet kombëtare për shpifjen duhet të përfshijnë rregulla të qarta për dhënien e dëmshpërblimeve financiare. Dëmshpërblimet financiare për të kompensuar humbjet aktuale financiare ose dëmin material duhen dhënë vetëm kur humbja ose dëmi janë përcaktuar specifikisht.

Niveli i kompensimit që mund të jepet për dëme jopasurore për reputacionin – me fjalë të tjera, dëm që nuk mund të matet në terma monetare – duhet t'i nënshtrohen një tavanit fikse. Ky maksimum duhet zbatuar vetëm në rastet më serioze. Shpërblimet financiare që tejkalojnë kompensimin për dëmtim të reputacionit duhet të jenë masa tepër të veçanta, që zbatohen vetëm kur pala paditëse ka vërtetuar se pala e paditur ka vepruar me dijeni të pavërtetësisë së deklaratës dhe me synim specifik dëmtimin e palës paditëse.<sup>74</sup>

**Rekomandime:**

- Kodi Civil duhet t'u japë përparësi dëmshpërblimeve jofinanciare.

<sup>72</sup> Shih *Përkufizimin e Shpifjes*, shënimi 3, Parimi 14.

<sup>73</sup> *Tolstory Miloslavski kundër Mbretërisë së Bashkuar*, shënim 50.

<sup>74</sup> Shih *Përkufizimin e Shpifjes*, shënimi 3, Parimi 15.

- Kodi Civil duhet të përcaktojë rregulla dhe të japë udhëzime për nivelin e dëmeve që mund të kompensohen, në përputhje me sa më lart.

### III.2.5 E Drejta për Replikë dhe Përgënjeshttrim

Ligji shqiptar parashikon të drejtën e përgjithshme për përgënjeshttrim në nenin 617 të Kodit Civil dhe të drejtën për ‘përgënjeshttrim’ – kufizuar në median elektronike – në nenin 47 të Ligjit për Radion dhe Televizionin Publik e Privat.

Në shumë demokraci të Evropës Perëndimore, e drejta për ‘përgënjeshttrim’ ose replikë parashikohet me ligj dhe këto ligje zbatohen në masa të ndryshme. Qëllimi i së drejtës për replikë është t’i japë individit mundësinë të ndreqë faktet e pasakta që ndërhyjnë në të drejtën e tij/saj për jetën personale ose reputacionin. Megjithatë, duke pasur parasysh se e drejta e replikës përbën ndërhyrje në lirinë editoriale,<sup>75</sup> mbrojtësit e lirisë së medias, përfshirë ARTIKULLIN 19, përgjithësisht sugjerojnë se e drejta e replikës duhet të jetë sipas dëshirës dhe jo e parashikuar me ligj. Gjithsesi, duhen zbatuar disa kriterë:

- Replika duhet të jetë vetëm si përgjigje ndaj deklaratave të pasakta ose çorientuese, të cilat shkelin një të drejtë të ligjshme të palës paditëse; nuk duhet të lejohet të përdoret për komente rreth opinionëve që lexuesit ose shikuesit nuk i pëlqejnë.
- Replika duhet të jetë po aq e dukshme sa edhe artikulli ose kronika të cilës i referohet.
- Gjatësia e replikës duhet të jetë në raport të drejtë me përmasat e artikullit ose kronikës të cilës i referohet.
- Replika duhet të kufizohet në trajtimin e fakteve të pasakta ose çorientuese në tekstin të cilit i referohet dhe nuk duhet marrë si një mundësi për të paraqitur çështje të reja ose komente rreth fakteve të sakta.
- Medias nuk duhet t’i kërkohet të transmetojë një replikë që është abuzive ose e paligjshme.

Sipas këtyre kushteve, skemat e parashikuara nga Kodi Civil dhe Ligji për Radion dhe Televizionin Publik e Privat paraqesin disa vështirësi.

Së pari, të dyja procedurat janë statutores. Kjo është e ashpër në këndvështrimin e medias, por në rastin e Kodit Civil, që kërkon një mandat të lëshuar nga gjykata, paraqet gjithashtu një procedurë me prag të lartë për palën paditëse. Për të dyja këto arsye, ne rekomandojmë që të shihet mundësia për të drejtën e replikës vetë-rregulluese ose për një skemë përgënjeshtrimi.

Së dyti, në lidhje me Kodin Civil, ne vërejmë se ai parashikon që një gjykatë mund të kërkojë botimin e një përgënjeshtrimi “kur është vërtetuar që një person mban përgjegjësi ligjore kundrejt një personi tjetër, për shkak se ka botuar të dhëna të pasakta, të paplota ose mashtruese ... në mënyrën që gjykata e konsideron të përshtatshme”. Kjo i jep gjykatës liri të madhe veprimi në caktimin e mënyrës dhe formës së botimit të përgënjeshttrimit. Do të parapëlqehet që legjislacioni të jepte udhëzime lidhur me këto çështje.

<sup>75</sup> Shih *Ediciones Tiempo S.A. kundër Spanjës*, 12 korrik 1989, Aplikimi Nr. 13010/87 (Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut)

Së treti, neni 47 i Ligjit për Radion dhe Televizionin Publik e Privat parashikon të drejtën për ‘përgënjeshttrim’ ndaj ‘informacioneve false’. Kjo do të thotë që shikuesit ose dëgjuesit do t’i jepet hapësirë në median elektronike për të sjellë argumentet e tija, gjë që do të përbënte një ndërhyrje shumë më të madhe se sa e drejta e thjeshtë për përgënjeshttrim e parashikuar nga neni 617 i Kodit Civil. Ligji, ashtu si Kodi Civil, nuk arrin të vendosë kufizime për formatin e ‘përgënjeshttrimit’, përveç një dispozite të përgjithshme se ai nuk duhet të jetë “shumë më i gjatë” se deklarata e presupozuar e rreme për të cilën reagohet.

**Rekomandime:**

- E drejta e përgënjeshttrimit në Ligjin për Radion dhe Televizionin Publik e Privat dhe e drejta për përgënjeshttrim në Kodin Civil duhen reformuar sipas linjës së parashtruar më lart.